



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:108953

Datë: 05.07.2024

Numri i dokumentit: 05905817

KE.nr.300/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A., me numër unik identifikues 810500604, me seli në rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Prishtinë, të cilin e përfaqëson F.K., kundër të paditurit “Naki-Trade” SH.P.K., me numër unik identifikues 810835879 me adresë rr. “Agim Ramadani” nr. 22/65, Prishtinë, jashtë seancës me datën 05.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas padisë së paditësit Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A., me numër të lëndës KE.nr. 300/24 (2024:108953), kundër të paditurit “Naki-Trade” SH.P.K., me objekt kontesti lirim i pronës dhe kompensim dëmi.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Komerciale të Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A., me datë 11.04.2024 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, kundër të paditurit “Naki-Trade” SH.P.K., me të cilën kanë kërkuar lirim e pronës dhe kompensimin e dëmit.

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata

Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, lidhur me paragrafin 2 i cili përcakton se: *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”*, vlerëson se çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat sendore siç janë të parapara me LPDTS, nuk bien në kompetencë të Departamenti për Çështje Ekonomike, por në kuptim të neni 13 par.1, pika 1.7 trajtohen në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm të kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.300/24, datë 05.07.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.